



# **LIBRI I MËSUESIT**

## **FIZIKA 6**

**Shkolla e mesme e ultë**



## **Përmbajtja**

<b>Parathënie.....</b>	<b>5</b>
<b>1. Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore për shkallën 3 (RNK) .....</b>	<b>6</b>
<b>2. Rezultatet e të nxënit për fushë për shkallën 3 (RNF) .....</b>	<b>11</b>
<b>3. Rezultatet e të nxënit për lëndë (RNL) .....</b>	<b>17</b>
<b>4. Plani mësimor vjetor .....</b>	<b>20</b>
<b>5. Plani mësimor i periudhës I .....</b>	<b>21</b>
<b>6. Planet e orëve mësimore të periudhës I .....</b>	<b>23</b>
<b>7. Plani mësimor i periudhës II .....</b>	<b>47</b>
<b>8. Planet e orëve mësimore të periudhës II .....</b>	<b>49</b>
<b>9. Plani mësimor i periudhës III .....</b>	<b>66</b>
<b>10. Planet e orëve mësimore të periudhës III .....</b>	<b>68</b>
<b>11. Një model i testit vlerësues.....</b>	<b>82</b>



## Parathënie

Të dashur mësimezhënës!

Paketa mësimore e lëndës së Fizikës për klasën e VI të Shkollës së Mesme të Ulët, përbehet prej tre librave: libri themelor, fletorja e punës dhe libri i mësuesit. Të gjitha këto janë në harmoni dhe e plotësojnë njëra tjetrën.

Libri i mësuesit është mjet i punës i cili juve do ju ndihmoj në realizimin me sukses të programit mësimor për lëndën e Fizikës. Në klasën e gjashtë, nxënësit për herë të parë takohen me Fizikën. Nëse nuk do të jemi të kujdesshëm atëherë ka gjasë që nxënësi ose të frikohet nga kjo lëndë ose mos të ketë ndenja fare për lëndët natyrore në përgjithësi e për Fizikën në veçanti. Puna e lëndëve të reja mësimore është sikurse e notit në ujë. Nëse atë nuk e mësojmë prej ditës së parë ashtu si duhet, tërë jetën do të frikohemi se mund të fundosemi, ose nuk do kemi vullnetin për të notuar.

Prandaj, nëse ne prej ditës së parë nxënësve Fizikën ua ofrojmë ashtu siç duhet, shumë prej tyre jo vetëm se do ta pëlqejnë këtë lëndë, mirëpo do jenë edhe pjesë aktive në orët e juaj. Pjesa tjetër me kalimin e kohës do ta zë hapin. Kjo mund të arrihet vetëm nëse qasjen në këtë lëndë e kemi për toke. Çfarë dua të them, nuk guxojmë që në orën e parë mësimore ti tregojmë “dhëmbët” e Fizikës nxënësve. Ajo i bie sikurse atë që nuk di notë, herën e parë ta fusim në mes deti!!! Për shembull, nuk është metodike, dhe as e mirë në kuptimin njerëzor që në orët e parë nxënësit ti frikësojmë me formula e grafike, ose duke treguar pjesë të caktuar të historisë së fizikanëve botërorë. Si e kemi mësuar Matematikën në klasën e parë? A patëm filluar me thyesa, me gjeometri, apo me disa kuptime logjike të thjeshta? Thjeshtë, duhet të jemi shume të kujdesshëm, sepse hapi i parë është vendimtar për jetë.

Për këtë qëllim të dashur mësimezhënës është ky libër i emëruar si i mësuesit. Tingëllon ëmbël, sepse ju keni rastin për herë të parë, nxënësit të klasës së VI ti mësoni Fizikë.

Përmbajtja e librit është koherente me librin bazik, përkatësisht me programin mësimor të aprovuar nga MASHT me datë 11.04.2018. Ky libër do ju ndihmoj juve që të arrin synimet dhe qëllimet e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.

Për të pasur më lehtë realizimin e programit mësimor, dhe për të qenë më efikas, duhet të kemi një shtrirje homogjene të tërë materies mësimore për gjatë vitit. Grumbullimi i shumë njërive mësimore për një orë, pastaj jo kombinimi i mësimezhënies me ushtrime qofshin ato numerike ose eksperimentale, nuk janë efikase dhe të suksesshme për mos të thënë janë kancer i lëndës.

Ne, për mes këtij libri do ju ofrojmë shembullin e ndërtimit të planit mësimor vjetor për lëndën e Fizikës, e pastaj do të mundohemi që për disa orë mësimore të paraqesim modele të cilat juve do ju ndihmojnë në realizimin e suksesshëm të orës mësimore.

Tërë programi i lëndës është i sistemuar në tetë tema mësimore, të cilat duhet të zhvillohen për 70 përkatësisht 72 orë mësimore (varet edhe nga festat), të shpërndara në tri periudha të vitit shkollor.

Mund të ndodhë që për arsye objektive ose subjektive të ketë zhvendosje të ndonjë njërive mësimore në aspektin kohor, mirëpo jo luhatje të mëdha. E rëndësishme është mos të ketë prishje të mëdha të homogjenitetit në shpërndarje të lëndës.

Në vazhdim do të trajtojmë radhazi programin mësimor. Për këtë qëllim, po ashtu në kuadër të secilës periudhë do bëjmë shpërndarjen homogjene të njërive mësimore si dhe aktiviteteve përcjellëse. Pastaj do të prezantojmë modelin e disa orëve mësimore veç e veç.

Më kënaqësinë më të madhe presim vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e juaj.

# 1. Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore për shkallën 3 (RNK)<sup>1</sup>

## 1.1. Kompetencat kryesore të të nxënit

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive shkathtësive dhe i qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat i dëshmojnë se nxënësit janë aftësuar të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura. Kompetencat burojnë nga qëllimi i përgjithshëm i arsimit parauniversitar, të cilat janë rezultat i të nxënit të njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme përgjatë niveleve të caktuara të sistemit arsimor. Ato duhet të dëshmojnë se për çka janë të aftë nxënësit pas një periudhe të caktuar të të nxënit.

### ***Këto kompetenca janë:***

1. Kompetenca komunikimi dhe të shprehurit
2. Kompetenca të menduarit
3. Kompetenca të mësuarit për të nxënë
4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
5. Kompetenca personale
6. Kompetenca qytetare.

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm.

Kompetencat *komunikimi dhe të shprehurit, kompetenca të menduarit dhe kompetencat për të mësuar* janë të natyrës instrumentale: ato janë bazë për kompetencat e tjera, të cilat më tepër janë të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale.

### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv)**

Me qëllim që nxënësit dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehin në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

### **Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ/krijues dhe kritik)**

Përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t'iu qasur informatës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete për t'iu qasur njohurive dhe për t'i përpunuar dhe gjykuar në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese.

### **Kompetenca e të mësuarit (për të nxënë) tërë jetësor (Nxënës i suksesshëm)**

Për një nxënës të suksesshëm shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërkueshmëri dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar.

Shkolla po ashtu duhet të vetëdijësohet për stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

### **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribuues produktiv)**

Shkolla angazhohet që nxënësi/ja të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijësohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Për të zhvilluar këtë kompetencë nxënësi/ja përkrahen që të kuptojë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore. Njëkohësisht, duke e pasur parasysh arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, ai/ajo përgatitet që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.

### **Kompetenca personale (Individ i shëndoshë)**

Shkolla përgatit nxënësit që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare,

<sup>1</sup>Kurrikula bërthamë, MASHT, shkurt 2017, faqe 18-23

shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

### **Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm)**

Shkolla përgatit nxënësin/en për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfida kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Kjo kompetencë siguron që nxënësi të jetë në gjendje të veprojë si qytetar i përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë të zhvillimeve në shoqëri.

## **1.2. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore për shkallë**

Kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënit për shkallë. Ato janë pjesë e Kurrikulave bërthamë dhe parashihet të arrihen nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle kurrikulare. Rezultatet e të nxënit nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritjes kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar si dhe promovojnë integrim të mëtejshëm të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me Kornizën kurrikulare.

Secila fushë e kurrikulës, si një tërësi e organizimit të procesit mësimor, ndihmon zhvillimin dhe arritjen e kompetencave kryesore nga nxënësit. Po ashtu edhe çështjet (temat) ndër kurrikulare dhe jashtë kurrikulare (veprimtaritë jashtë kurrikulare) luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe arritjen e kompetencave kryesore, përkatësisht ndihmojnë nxënësit në arritjen rezultateve të kompetencave për shkallë kurrikulare.

Rezultati i të nxënit përkufizohet si: “Deklaratë që përshkruan atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli”. Ai shpreh një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca në nivel shkalle artikulojnë pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Ato (REN) janë bazament për hartimin e programeve mësimore, organizimit mësimor në shkollë, hartimit të teksteve shkollë dhe të materialeve të tjera mësimore.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës 3- (klasat VI dhe VII)**

Rezultatet e kompetencave kryesore që priten të përvetësohen nga nxënësit deri në fund të shkallës së tretë.

Nr.	Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore
I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
1	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

6	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7	Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8	Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën jo amtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndër vepruar në grup ose në klasë.

### Zhvillimi i mëtejshëm dhe orientimi (klasat VI dhe VII)

<b>II</b>	<b>Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik</b>
1	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
2	Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
4	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse
5	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
6	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.
<b>III</b>	<b>Kompetenca të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>
1	Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë.
2	Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj.
3	Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre.
4	I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare.
5	Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve.
6	Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
7	Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të pa qarta



8	Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin apo ngecjen në fusha të ndryshme mësimore.
<b>IV</b>	<b>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis-Kontribuues produktiv</b>
1	Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.
2	Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin.
3	Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit.
4	Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.
5	Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës, arsyeton pastaj rëndësinë e krijimit të shprehisë për të planifikuar.
6	Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.
7	Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik etj., si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile.
8	Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit (me anë të fotografive, video projektimit të të dhënave nga terreni) dhe në bazë të tyre organizon aksione vullnetare dhe humanitare për plotësimin ose përmirësimin e atyre nevojave.
<b>V</b>	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>
1	Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm.
2	Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative të paktën të tri llojeve të ushqimeve të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.
3	Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.
4	Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.
5	Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.
6	Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit
7	Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.
8	Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.
9	Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.
10	Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara.
<b>VI</b>	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>

1	Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë
2	Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndër personale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
4	Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme nga mediet, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më.
5	Shpjegon, në forma të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit
6	Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.
7	Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.
8	Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

## 2. Rezultatet e të nxënit për fushë për shkallën 3 (RNF)<sup>2</sup>

Fokusi kryesor i të mësuarit të shkencave të natyrës është thellimi i të kuptuarit të koncepteve dhe ideve përmes lëndëve kimi, biologji dhe fizikë. Kjo u ndihmon nxënësve që t'i kuptojnë ndërlidhjet mes këtyre lëndëve dhe koncepteve për t'i argumentuar dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe të natyrës.

Nxënësit duhet t'i zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë dhe shkathtësitë për dijet, metodat, proceset për përdorimin të arriturave shkencore në jetën e përditshme. Ata inkurajohen të kuptojnë se si shkenca mund të përdoret për të shpjeguar se çka ka ndodhur rreth tyre si dhe t'i analizojnë shkaqet dhe pasojat.

Fusha kurrikulare *Shkencat e natyrës* ndihmon zhvillimin e integruar të kompetencave, të cilat ndihmojnë përgatitjen e nxënësve në aspektin social, shëndetësor e ekonomik dhe që lidhen me çështje të ndryshme në nivel kombëtar dhe global

### 2.1. Qëllimet

#### *Qëllimet e të mësuarit të shkencave të natyrës janë:*

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes eksplorimit të proceseve njerëzore, natyrore dhe fizike në mjedis.
- Zhvillimi i qasjes shkencore në zgjidhjen e problemeve e cila ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues.
- Inkurajimi i nxënësve të eksplorojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë idetë dhe konceptet shkencore përmes dizajnit dhe aktiviteteve praktike.
- Inkurajimi i nxënësve të vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë në mjekësi, ekonomi, kulturë dhe dimensione të tjera në shoqëri.
- Kultivimi i kujdesit dhe respektit për diversitetin e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla, varësinë dhe bashkëveprimin mes tyre.
- Inkurajimi i nxënësve të sillen me përgjegjësi për të mbrojtur, përmirësuar dhe dashur mjedisin duke u involvuar në identifikimin, diskutimet dhe aktivitetet për problemet mjedisore që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
- Gatishmëria e nxënësve të komunikojnë idetë, prezantojnë punën dhe raportojnë të gjeturat e hulumtimeve përmes medieve të ndryshme.
- Zotërimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve në shkenca.

### 2.2. Konceptet e përgjithshme dhe përshkrimi i tyre

#### *Konceptet e përgjithshme të fushës shkencat e natyrës janë:*

1. Materia, vetitë dhe shndërrimet
2. Proceset fizike
3. Bota e gjallë
4. Toka, mjedisi dhe gjithësia

#### **Materia vetitë dhe shndërrimet**

Nënkuptojnë njohjen, përshkrimin, klasifikimin dhe krahasimin e objekteve, trupave, lëndëve të agregate dhe shndërrimeve kimike;

#### **Proceset fizike**

Kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e llojeve të ndryshme të lëvizjeve, të ligjeve të bashkëveprimit të forcave në mekanikë, të punës, të energjisë dhe ruajtjes së saj, të fuqisë, të punës

---

<sup>2</sup>Kurrikula bërthamë, MASHT, shkurt 2017, faqe 56-64

dhe nxehtësinë së gazeve, të lëkundjeve, të valëve dhe zërit, të ligjeve të elektricitetit, të magnetizmit, të burimeve të dritës dhe strukturës së lëndës, me qëllim të shfrytëzimit në jetën e përditshme.

### **Bota e gjallë**

Ka të bëjë me proceset jetësore që përfshijnë dallimin dhe shpjegimin e njohurive për biodiversitetin si kompleks, përshtatshmëritë dhe llojllojshmërinë, lidhjen strukturore dhe funksionale të komponenteve të ekosistemit, të kuptuarit e faktorëve të ekologjikë, sjelljet e organizmave në mjedisin e tyre jetësor, riprodhimi i organizmave të gjallë, roli i njeriut në ekosistem.

### **Toka, mjedisi dhe gjithësia**

Nënkupton njohjen dhe shpjegimin e gjeocentrizmit dhe heliocentrizmit, (Ptolemeu, Koperniku, Kepleri dhe Njutoni) të lëvizjes së dukshme të Diellit nëpër ekliptikë dhe rrjedhojat e kësaj lëvizje, të lëvizjes së dukshme dhe të vërtetë të planetëve rreth Diellit, të ligjeve të lëvizjes së vërtetë të trupave të sistemit diellorë, të pozitës së Diellit në Galaktikë dhe largimin reciprok të galaktikave.

## **2.3.Rezultatet e të nxënimit për fushë për shkallën 3**

SHKALLA 3, KLASA VI,VII (MOSHA 12-13 VJEÇ)
<b>I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËRMES PROCESIT TË TË NXËNIMIT</b>
1.Zhvillimi i shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive në natyrë
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. I kushton kujdes saktësisë, precizitetit dhe produktit gjatë punës.</li> <li>2. Ofron hipoteza të bazuara në një numër vëzhgimesh dhe të dhëna të vlefshme</li> <li>3. Propozon ide ose teori të thjeshta të cilat mund të demonstrohen me eksperiment.</li> <li>4. Grumbullon informata dhe të dhëna nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë klasës dhe nga TIK-u.</li> <li>5. Zbaton rregullat e sigurisë gjatë punës praktike (duke përfshi edhe shenjat e rrezikut).</li> <li>6. Prezanton shpjegime të arsyeshme, duke përfshi të dhënat nga parashikimet dhe hipotezat.</li> </ol>
<b>II. STRUKTURIMI I MENDIMIT SHKENCOR PËR KONCEPTET, MODELET, TEORITË DHE LIGJET E NDËRTIMIT TË MATERIES, TË PROCESVE DHE DUKURIVE NË NATYRË(PROCESET DHE DUKURITË FIZIKE, KIMIKE, BIOLOGJIKE DHE GJEOGRAFIKE NË TOKË DHE NË GJITHËSI)</b>
1. Materia, vetitë dhe shndërrimet
1. Dallon dhe klasifikon lëndët sipas përbërjes, strukturës, vetive fizike dhe kimike, shndërrimeve dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme.
2. Bota e gjallë
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</li> <li>2. Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.</li> </ol>
3. Proceset fizike
1. Përshkruan vetitë e lëndës, lëvizjen, forcat e bashkëveprimit energjinë dhe shndërrimet e saja, ligjet e ruajtjes, lëvizjen kinetike dhe termike me qëllim të ngritjes së njohurive shkencore.
4.Toka, mjedisi dhe Gjithësia
1. Shpjegon përbërjen e litosferës, hidrosferës, atmosferës, biosferës, proceset në to dhe ndërrimet e thjeshta të pozitës së trupave gjatë kohës.
<b>III. QËNDRIMET DHE VLERAT E STRUKTURUARA NGA ARSIMIMI PËRMES FUSHËS SË SHKENCAVE NATYRORE</b>
Nxënësi pritët të manifestojë:

1. Qëndrim pozitiv për studimin shkencor në përgjithësi.
2. Tolerancë ndaj opinionëve të shprehura nga të tjerët.
3. Kureshtje për simulim dhe modelim të dukurive natyrore përmes eksperimentit.
4. Motivim për studimin e shkencës si fushë e rëndësishme në jetën shoqërore dhe profesionale.
5. Iniciativë dhe interesim për t'iu qasur detyrave të ndryshme.
6. Interesim për përdorimin e koncepteve dhe metodave specifike shkencore në zgjidhjen e problemeve shkencore në jetën e përditshme.
7. Kujdes për kualitetin dhe ruajtjen e mjedisit.
8. Të menduarit kritik dhe pozitiv, ndershmëri dhe tolerancë.
9. Interesim në zbatimin e dijes në jetën e përditshme.
10. Interesim për arritjet e reja dhe përparimet në shkencë.
11. Respekt ndaj diversitetit natyror dhe njerëzor, ruajtje dhe mbrojtje të mjedisit

#### IV. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË NË SHKENCAT NATYRORE

1. Identifikim
2. Përshkrim
3. Formulim
4. Arsyetim
5. Zbatim
6. Njehsime
7. Matje
8. Skicime
9. Krijim modelesh
10. Ndërtim
11. Përdorim burimesh dhe informacionesh
12. Shkathtësi bashkëpunimi
13. Shkathtësi komunikimi
14. Aftësi psikomotorike
15. Kreativitet
16. Shkathtësi të mendimit kritik
17. Shkathtësi në teknologji të informatikës
18. Shkathtësi numerike
19. Shkathtësi të zgjidhjes së problemeve
20. Shkathtësi menaxhimi

### 2.4. Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare po ashtu aktiviteteve jashtë kurrikulare, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Rezultatet e të nxënësve për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënësve për fushë (RNF-të) – Shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL) – paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve por edhe për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike e të tjera. Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe t'iu përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale,

fetare. Metodrat, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore, të njohurive, shprehjeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera për të përballur sfidat jetësore. Shkencat e natyrës janë shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

***Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:***

2.4.1. Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

2.4.2. Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);

2.4.3. Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

2.4.4. Diskutimi dhe të nxënës në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

2.4.5. Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

2.4.6. Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;

2.4.7. Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

2.4.8. Të mësuarit dhe të nxënës përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

2.4.9. Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

2.4.10. Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura. Çështje ndër kurrikulare. Integrimi i çështjeve ndër kurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të

njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

**Mësimdhënia dhe të nxënës e integruar**

**Integrimi i koncepteve të përbashkëta në shkencat natyrore (biologji, kimi, fizikë):**

Lënda dhe energjia në zhvillimin e jetës, interpretimi i proceseve dhe dukurive natyrore dhe ndikimi i tyre te njeriu, qeniet e gjalla dhe në mjedis, shndërrimet e lëndës, ndërveprimet mes lëndës, trupave dhe qenieve të gjalla, atomet, molekulat, ligji i ruajtjes së masës dhe energjisë, tretësirat, fotosinteza, frymëmarrja, ushqimi i shëndetshëm.

**Integrimi në metodën shkencore hulumtuese:**

Vëzhgimi, klasifikimi, matja, modelimi, parashtrimi i hipotezës, eksperimenti, prova, përdorimi i instrumenteve për matje, planifikimi dhe projektimi i hulumtimeve të thjeshta shkencore, përpunimi i rezultateve, siguria gjatë punës në laborator.

**Ndërlidhja e shkencave natyrore me fushat e tjera**

Shkencat e natyrës jo vetëm se janë të ndërlidhura në mes veti, meqë e studiojnë natyrën në aspekte të ndryshme, por janë të ndërlidhura edhe me fushat tjera studimore, veçanërisht me gjuhët në funksion të ndërtimit të terminologjisë dhe komunikimit.

**Komunikimi dhe të shprehurit**

Komunikon në gjuhë amtare dhe në gjuhë të huaja gjatë punës në grup, pasuron fjalorin e gjuhës me shprehje e simbole të reja përmes diskutimit, raporteve me shkrim, të punëve praktike, hulumtimeve dhe matjeve.

**Matematika**

Përdor formulat, për vendosje të raporteve në mes madhësive që e karakterizojnë natyrën për dukuri të caktuar si dhe për ndërtimin e modeleve dhe njehsimit të rezultateve të fituara gjatë matjeve eksperimentale në shkencë të natyrës.

**Shoqëria dhe mjedisi**

Trajton mjedisin natyror-shoqëror si një pasuri, e cila duhet të ruhet dhe të shfrytëzohet për të mirat e shoqërisë.

**Shëndeti dhe mirëqenia**

Mbron shëndetin duke respektuar rregullat e higjienës, të ushqimit, të lëvizjeve trupore dhe të organizimit të pushimit dhe vetëdijesohet për t'u mbrojtur nga alkooli, duhani, drogat, HIV/AIDS dhe nga shtatzënia e padëshiruar.

### **Jeta dhe puna**

Respekton parimet e punës në grup dhe bashkëpunon në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të përcaktuara duke shfaqur shkathtësi manovruese në përdorimin e veglave, pajisjeve dhe teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të marrë informacione gjatë hulumtimeve.

### **Temat ndër kurrikulare**

*Temat ndër kurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:*

- Edukimi për medie;
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

### **Edukimi për media**

I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur me publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijesimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlihet me vetëdijesimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

## **2.5. Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to. Vlerësimi i nxënësve mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndor dhe shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në shkencat e natyrës.

Metodat e vlerësimit që duhet të përdoren në shkencat e natyrës:

- Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)
- Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës),
- Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale
- Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte
- Vlerësimi i portfolios
- Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore
- Vlerësimi i detyrave të shtëpisë

Vlerësimi i nxënësve për të gjitha format e lartshënuara mund të realizohet edhe në formë elektronike. Mësimdhënësit e shkencave natyrore, për shkak të specifikave që ka fusha, duhet të përdorin sa më shumë instrumente vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere, i hartuar nga vetë mësimdhënësit, në harmoni me planin zhvillimor të shkollës, me vendimmarrjen e DKA-ve dhe me politikat e MASHT-it.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit).

## **2.6. Materialet dhe burimet**

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm

mësimor. Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj.), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atlase etj. Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj. Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrë është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).



### 3. Rezultatet e të nxënit për lëndë (RNL)<sup>3</sup>

Rezultatet e të nxënit për lëndë janë marrë nga Kurrikulat lëndore/programet mësimore, për klasën e gjashtë, botuar nga MASHT, më 2018; si dhe nga libri kryesor Fizika 6botuar nga e njëjta shtëpi botuese, i cili është përpiluar në përputhje me dokumentin e parë.

Koncepti : **I.** Lëvizja; **II.** Struktura e lëndës; **III.** Bashkëveprimi; **IV.** Energjia;

Koncepti	TEMA	Rezultatet e të nxënit sipas lëndës (RNL)
II	1. LËNDA E STUDIMIT TË FIZIKËS, DISA NGA MADHËSITË THEMELORE NË FIZIKË, TRUPAT DHE SISTEMET	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. përkufizon fizikën si shkencë të natyrës dhe paraqet shembuj të studimit të saj.</li> <li>1.2. tregon dukuri të cilat janë fushë e studimit të shkencave të natyrës ( kimi, biologji dhe astronomi).</li> <li>1.3. përshkruan vetitë themelore karakteristike të dallimit të trupave dhe objekteve në natyrë.</li> <li>1.4. identifikon gjatësinë, kohën dhe masën e trupit si madhësi themelore në fizikë.</li> <li>1.5. përkufizon sistemin si tërësi pjesësh që punojnë së bashku dhe në harmoni.</li> <li>1.6. përshkruan sistemin diellor si sistem të përbërë nga Dielli, planetët dhe trupat e vegjël.</li> <li>1.7. tregon sisteme themelore të ndërtimit të bimëve, kafshëve dhe njeriut.</li> <li>1.8. demonstroi eksperimentalisht punën e qarkut elektrik si sistem, dhe përshkruan sisteme tjera të ndërtuara nga njeriu.</li> <li>1.9. zgjidhë detyra numerike për përcaktimin e masës, vëllimit dhe densitetit të trupit</li> </ol>
II	2. PROCESET NË NATYRË DHE MATJET E DISA MADHËSIVE NË FIZIKË	<ol style="list-style-type: none"> <li>2.1. shpjegon ndërrimet që shkaktohen nga natyra (fizikë, kimi, biologji dhe astronomi) dhe nga njeriu.</li> <li>2.2. dallon ndërrimet fizike, ndërrimet kimike dhe ndërrimet biologjike të trupave në natyrë.</li> <li>2.3. paraqet shembuj të proceseve të kthyeshme dhe procese të pakthyeshme në natyrë (fizikë, kimi, biologji dhe astronomi).</li> <li>2.4. tregon shembuj të proceseve ciklike të lëndës dhe trupave në natyrë (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi) dhe të riciklimit nga njeriu.</li> <li>2.5. përshkruan matjen si krahasim me një standard të paracaktuar.</li> <li>2.6. demonstroi eksperimentalisht matjen e gjatësisë, sipërfaqes, vëllimit, masës, dhe kohës së zgjatjes së një ndodhie me ndihmën e veglërisë gjegjëse.</li> <li>2.7. demonstroi eksperimentalisht përcaktimin e densitetit të trupit me formë të pa rregullt.</li> <li>2.8. demonstroi eksperimentalisht matjen e të njëjtës madhësi themelore disa herë dhe arrin deri te përkufizimi i vlerës mesatare të saj.</li> </ol>

<sup>3</sup>Kurrikulat lëndore/programet mësimore, MASHT gusht 2018, faqe 98-103

I, III	3. LËVIZJA DHE BASHKËVEPRIMET	<p>3.1. shpjegon lëvizjen e trupit si ndërrim të pozitës së tij ndaj një sistemi referimi në hapësirë dhe kohë.</p> <p>3.2. demonstroi eksperimentalisht kuptimin e shpejtësisë dhe paraqet lëvizjen e njëtrajtshme drejtvizore në mënyrë tabelore dhe grafike.</p> <p>3.3. trajton me shembuj masën, si rezistencë ndaj ndryshimit të gjendjes së lëvizjes.</p> <p>3.4. identifikon forcën si madhësi fizike të bashkëveprimit, ndryshimit të shpejtësisë dhe drejtimit të lëvizjes.</p> <p>3.5. përshkruan shembuj për bashkëveprime në distancë dhe bashkëveprime me takim.</p> <p>3.6. demonstroi eksperimentalisht rënien e lirë, forcën e rëndesës, forcën e fërkimit dhe forcën elastike</p> <p>3.7. demonstroi eksperimentalisht peshën e trupit si forcë të veprimit të tij mbi bazë, ose në pikën e varjes.</p> <p>3.8. demonstroi eksperimentalisht shtyrjen, tërheqjen, ngritjen dhe deformimet e trupave si lloje të bashkëveprimeve.</p> <p>3.9. demonstroi eksperimentalisht matjen e masës dhe matjen e peshës me veglërisë përkatëse.</p> <p>3.10. demonstroi eksperimentalisht bashkëveprimet e forcave paralele, me kahe të kundërta dhe kur mbyllin kënd të drejtë në mes veti.</p> <p>3.11. zgjidhë detyra numerike për përcaktimin e rrugës, shpejtësisë, kohës së lëvizjes së trupi dhe veprimeve me forca.</p>
I, III	4. SHTYPIA DHE RRJEDHJËSIT	<p>4.1. përkufizon shtypjen si herës në mes të forcës dhe sipërfaqes së veprimit.</p> <p>4.2. demonstroi eksperimentalisht përhapjen e shtypjes në lëngje.</p> <p>4.3. demonstroi eksperimentalisht vërtetime për paraqitjen e shtypjes atmosferike.</p> <p>4.4. trajton lëvizjen e fluidit si rrjedhojë të shkaktuar nga ndryshimi i shtypjes.</p> <p>4.5. përshkruan vetitë themelore të shtresave të atmosferës dhe lëvizjet e ajrit nga temperatura.</p> <p>4.6. zgjidhë detyra numerike për përcaktimin shtypjes, forcës apo sipërfaqes së veprimit.</p>
IV	5. ENERGJIA, PUNA, FUQIA DHE MAKINAT E THJESHTA	<p>5.1. dallon trajta të ndryshme të energjisë, (mekanike, elektrike, magnetike, kimike, biologjike etj.)</p> <p>5.2. përshkruan energjitë mekanike dhe paraqet shprehjet e tyre.</p> <p>5.3. identifikon elektricitetin si bartës të energjisë.</p> <p>5.4. tregon shfrytëzimin e energjisë, kimike dhe biologjike në jetën e përditshme.</p> <p>5.5. shpjegon energjinë si madhësi konstante të një trupi a sistemi dhe shndërrimet e saj.</p> <p>5.6. identifikon punën si mekanizëm për transferin e energjisë mekanike.</p> <p>5.7. përkufizon fuqinë si raport në mes energjisë së transferuar dhe kohës së transferit.</p> <p>5.8. dallon energjinë Diellore si burimin kryesor të energjisë në Tokë.</p> <p>5.9. përkufizon energjinë si veti e trupit a sistemit, e cila mund të shkaktojë ndryshime.</p> <p>5.10. vlerëson përparësitë e burimeve të energjisë së pastër ndaj burimeve të energjisë së djegies së fosileve dhe lidhjen e shfrytëzimit të tyre me ndotjen e mjedisit.</p> <p>5.11. ilustron parimin e punës së makinave të thjeshta.</p> <p>5.12. demonstroi eksperimentalisht punën me lloz, rrafsh të pjerrët dhe rrotë.</p> <p>5.13. zgjidhë detyra numerike për energjitë mekanike, punë dhe fuqi.</p>

II, IV	6. DUKURITË TERMIKE	<p>6.1. përshkruan ndërtimin grimcor të lëndës dhe përkufizon energjinë e brendshme të trupit / sistemit</p> <p>6.2. demonstroi eksperimentalisht mënyrat e ndërrimit të energjisë së brendshme të trupit / sistemit.</p> <p>6.3. interpreton temperaturën si vlerësim të energjisë së brendshme të trupit/sistemit.</p> <p>6.4. interpreton nxehtësinë si mekanizëm për transferin e energjisë së brendshme.</p> <p>6.5. demonstroi eksperimentalisht matjen e temperaturës së njeriut dhe të atmosferës me termometër dhe përshkruan punën e termometrit me merkur dhe alkool.</p> <p>6.6. demonstroi eksperimentalisht rregullën e Richmanit për dy apo më shumë sisteme të ndryshme në gjendje të baraspeshimit termik.</p> <p>6.7. përshkruan ndërrimet e vetive fizike të trupave të shkaktuara nga nxehtësia.</p> <p>6.8. identifikon mënyrat e këmbimit të nxehtësisë.</p> <p>6.9. tregon punën e makinave të thjeshta termike dhe vlerëson rendimentin e tyre.</p>
II, III	7. NGARKESAT, RRYMAT DHE MAGNETET E PËRHESHME	<p>7.1. shpjegon paraqitjen e elektriciteteve të kundërta duke u bazuar në strukturën e ndërtimit të lëndës.</p> <p>7.2. tregon mënyrat e mundshme të ngarkimit të trupave me elektricitet.</p> <p>7.3. demonstroi eksperimentalisht vetitë elektrike të trupave dhe ndarjen e tyre në përçues dhe veçues.</p> <p>7.4. demonstroi eksperimentalisht paraqitjen e rrymës elektrike si lëvizje të ngarkesave në përçues.</p> <p>7.5. identifikon burimet e rrymës elektrike dhe shpenzuesit e llojeve të ndryshme.</p> <p>7.6. demonstroi eksperimentalisht qarkun elektrik me një dy apo tri burime dhe me një dy apo tre shpenzues dhe nxjerr përfundimet për lidhje të burimeve dhe rezistorëve.</p> <p>7.7. përshkruan veprime të ndryshme të rrymës elektrike.</p> <p>7.8. identifikon forma të ndryshme të magnetëve të përhershme dhe dallon magnetet e përhershme nga magnetet e rrymës elektrike.</p> <p>7.9. demonstroi eksperimentalisht dhe liston trupat që ndjejnë ndikimin e magnetëve të përhershme.</p>
IV	8. PËRHAPJA DREJTIVIZORE E DRITËS	<p>8.1. identifikon burime të ndryshme të dritës dhe dallon sipërfaqet ndriçuese (shkëlqimi) nga sipërfaqet që e reflektojnë dritën (ndriçimi).</p> <p>8.2. vërteton me shembuj, përhapjen drejtvizore të dritës, me krijimin e hijes dhe gjysmëhijes dhe me eklipsin e Hënës dhe Diellit.</p> <p>8.3. demonstroi eksperimentalisht ligjin e reflektimit dhe ligjin e thyerjes së rrezeve të dritës.</p> <p>8.4. përcakton me vizatim pozitën e shëmbëllimit në pasqyra të rrafshëta dhe shpjegon karakteristikat themelore të tij.</p> <p>8.5. përshkruan instrumentet e thjeshta optike (pasqyrat, thjerrat) dhe interpreton Shëmbëllimet e fituara nga to.</p> <p>8.6. demonstroi eksperimentalisht ngjyrat themelore përbërëse të dritës së bardhë pas përhapjes së saj nëpër prizëm optik (disperzioni).</p>

#### 4. Plani mësimor vjetor

Fusha: shkenca natyrore

Lënda: Fizikë

Shkalla: 3

Klasa: 6

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; I.6; I.9; II.1; II.2; II.3; II.4;II.5; II.6; II.7; III.1; III.2; III.3; III.4; III.5; III.6; III.7.

	Dymujori	Tema	Koncepti	Numri i orëve
Periudha I	Shtator Tetor	1. LËNDA E STUDIMIT TË FIZIKËS, DISA NGA MADHËSITË THEMELORE NË FIZIKË, TRUPAT DHE SISTEMET	II	8
		2. PROCESET NË NATYRË DHE MATJET E DISA MADHËSIVE NË FIZIKË		8
	Nëntor Dhjetor	2. PROCESET NË NATYRË DHE MATJET E DISA MADHËSIVE NË FIZIKË	II	8
		3. LËVIZJA DHE BASHKËVEPRIMET	I,III	8
Periudha II	Janar Shkurt	3. LËVIZJA DHE BASHKËVEPRIMET	I,III	8
		4. SHYTPJA DHE RRJEDHJËSIT	I,III	5
	Mars	5. ENERGJIA, PUNA, FUQIA DHE MAKINAT E THJESHTA	IV	8
		5. DUKURITË TERMIKE	II,IV	8
Periudha III	Prill Maj	6. NGARKESAT, RRYMAT DHE MAGNETET E PËRHERSHME	II,III	6
		7. NGARKESAT, RRYMAT DHE MAGNETET E PËRHERSHME	II,III	8
	Qershor	8. PËRHAPJA DREJTVIZORE E DRITËS	IV	4

## 5. Plani mësimor i periudhës I

Fusha: shkenca natyrore

Lënda: Fizikë

Shkalla:3

Klasa: 6

Dymujori	Periudha I					
	Tema	Njësia	Orë	Metodologjia e mësimdhënies <sup>4</sup>	Ndërlidhja me lëndët tjera dhe çështje ndër-kurrikulare	RNK <sup>5</sup>
Shtator - Tetor	<b>1. LËNDA E STUDIMIT TË FIZIKËS, DISA NGA MADHËSITË THEMELORE NË FIZIKË, TRUPAT DHE SISTEMET</b>	Natyra, materia dhe substanca.	1	2.4.3; 2.4.7	Kimi, Biologji, Astronomi, Gjeografi	I1; I3; II.1; II.6; III.4; III.7; IV.1;
		Vetit themelore të trupave. Masa, vëllimi dhe dendësia e trupave. Ushtrime numerike për dendësinë e trupave	2	2.4.3; 2.4.7	Kimi, Matematikë	I2; I3; I.6; II.4; III.1; IV.1;
		Madhësitë fizike themelore.	1	2.4.1	Matematikë	I2; I3; I.6; II.4; III.1; IV.1;
		Sistemi fizik. Sistemi diellor.	1	2.4.1	Gjeografi, Matematikë	I1; I3; II.1; II.6; III.4; III.7; IV.1; IV.4.;
		Sistemet themelore të ndërtimit të bimëve, kafshëve dhe njeriut	1	2.4.1	Biologji, Matematikë	I1; I3; II.1; II.6; III.4; III.7; IV.1; IV.4.;
		Qarku elektrik dhe sistemet tjera	1	2.4.7	Teknologji	I.2; I.4; I.6; II.5; III.5; III.6; IV.1;
		Natyra dhe njeriu	1	2.4.1; 2.4.7	Gjeografi, Biologji, Kimi	
		<b>2. PROCESET NË NATYRË DHE MATJET E DISA MADHËSIVE NË FIZIKË PROCESET NË NATYRË DHE MATJET E DISA MADHËSIVE NË FIZIKË</b>	Ndryshimet e trupave në natyrë	1	2.4.3; 2.4.7	Kimi
	Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme. Proceset ciklike. Riciklimi		1	2.4.3; 2.4.5	Kimi	I1; I3; II.1; II.6; III.4; III.7; IV.1;
	Madhësitë fizike dhe njësitë matëse. Matja e masës.		1	2.4.1; 2.4.10	Matematikë	I2; I3; I.6; II.4; III.1; IV.1;
	Matja e gjatësisë sipërfaqes dhe vëllimit.		1	2.4.1; 2.4.7	Matematikë	I.2; I.4; I.6; II.4; II.7; III.1; III.5; IV.1;
	Ushtrime numerike		1	2.4.2	Matematikë	
	Matja e kohës.		1	2.4.1; 2.4.7	Matematikë	I.2; I.4; I.6; II.4; II.7; III.1; III.5; IV.1;
	Test për vlerësim		1	2.4.3		
	Debat për testin		1	2.4.1; 2.4.3		

<sup>4</sup> Shih shifrat në faqe 14

<sup>5</sup> Shih shifrat në tabelën në faqe 7-10

<b>3. LËVIZJA DHE BASHKËVEPRIMET 2. PROCESET NË NATYRË DHE MATJET ...</b>	Përcaktimi i dendësisë të trupave të ngurtë me formë jo të rregullt.	1	2.4.4; 2.4.7	Matematikë	I.2; I.4; II.4; II.5; III.3; III.5; IV.1;
2	Përkthyer punën e ndonjë makine termike.		
<b>Kriteret e suksesit:</b>			
<b>Nxënësi:</b>			
1	Të kuptoj dhe të jetë në gjendje të dalloj këmbimin e nxehtësisë me rrymim dhe me rrezatim.		
2	Të njoh dhe të komentoj shembuj nga jeta e përditshme e këmbimit të nxehtësisë me rrymim dhe rrezatim.		
3	Të kuptoj punën dhe rëndësinë e makinave termike.		
4			
<b>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> libri, një tenxhere me ujë dhe furnelën me zjarr.			
<b>Përdorimi i TIK-ut:</b>			
<b>Çështjet e ndërlydhura (korrelacioni):</b> Kimia, Biologjia.			
<b>METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE</b>			
<p>Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);  Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);  Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;  Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutojeni me nxënës se si ndodhë ngrohja e klasës ose dhomës në shtëpi nga një radiator ose burim tjetër nxehtësie (p.sh. shporet).</li> <li>• Shpjegoni mekanizmin e rrymimit të ajrit me këtë rast.</li> <li>• Bashkërisht me nxënës shpjegoni mekanizmin e ngrohjes nga rrezet e Diellit.</li> <li>• Merrni edhe shembuj të tjerë (llamba, zjarri).</li> <li>• Mundësisht merrni një tenxhere dhe vendoseni mbi flakë. Në këtë rast, ju mund të shpjegoni tre mekanizmat e këmbimit të nxehtësisë.</li> <li>• Shpjegoni makinat termike, rëndësinë e tyre dhe merrni ndonjë shembull praktikë.</li> <li>• Shpjegoni dhe llogaritni koeficientin e dobishëm të makinave termike.</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i nxënësve</b>			
Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Fletore pune.			
<b>Reflektimi për rrjedhën e orës</b>			

## 9. Plani mësimor i periudhës III

Fusha: shkenca natyrore

Lënda: Fizikë

Shkalla:3

Klasa: 6

Dymujori		Periudha III				
		Tema	Njësia	Orë	Metodologjia e mësimdhënies	Ndërlidhja me lëndët tjera dhe çështje ndër-kurrikulare
Prill- Maj	7. NGARKESAT, RRYMAT DHE MAGNETET E PËRHERSHME	Elektriciteti veti e materies. Elektriciteti dhe ndërtimi substancës	1	2.4.1; 2.4.7	Kimi	I.1; I.2; I.3; I.4; II.6; III.1; III.4; IV.1;
		Mënyrat e ngarkimit të trupave me elektricitet. Përçuesit dhe veçuesit	1	2.4.2; 2.4.7	Kimi	I.1; I.2; I.3; I.4; II.6; III.1; III.4; IV.1;
		Rryma elektrike. Burimet dhe shpenzuesit e rrymës elektrike	1	2.4.3; 2.4.7	Kimi	I.1; I.2; I.6; II.6; III.2; III.3; III.4; IV.6;
		Qarku elektrik	1	2.4.2; 2.4.7	Kimi, Teknologji	I.2; I.3; I.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1; IV.6;
		Veprimet e rrymës elektrike.	1	2.4.4; 2.4.10	Kimi, Biologji	I.1; I.3; I.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1; IV.3;
		Ushtrime numerike	1			
	7. NGARKESAT, RRYMAT DHE MAGNETET E PËRHERSHME 8. PËRHAPJA DREJTVIZORE E DRITËS	Magnetet e përhershëm dhe të rrymës elektrike	1	2.4.3; 2.4.7	Gjeografi, Kimi	I.1; I.2; I.3; II.5; II.6; III.1; III.3; IV.1;
		Toka magnet i përhershëm. Magnetet e rrymës elektrike.	1	2.4.1; 2.4.7; 2.4.10	Gjeografi, Kimi	I.1; I.2; I.3; II.5; II.6; III.1; III.3; IV.1;
		Ndikimi i magneleve në trupat e tjerë.	1	2.4.4; 2.4.7	Kimi	I.2; I.4; II.5; II.6; II.7; III.1; III.2; III.4; IV.1;
		Drita dhe burimet e saj.	1	2.4.1; 2.4.3	Astronomi, Gjeografi	I.1; I.2; I.4; I.6; II.6; III.1; III.4; IV.1;
		Përhapja drejtvizore e dritës. Hija dhe gjysmëhija. Zënia e Diellit dhe Hënës	1	2.4.2; 2.4.7	Astronomi, Gjeografi, Matematikë	I.1; I.2; I.4; I.6; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;
Reflektimi dhe thyerja e dritës.	1	2.4.1; 2.4.7	Matematikë	I.1; I.3; I.4; II.4; II.5; II.6;		

Qershor	8. PËRHAPJA DREJTVIZORE E DRITËS	Instrumentet e thjeshta optike	1	2.4.1; 2.4.7; 2.4.5	Matematikë	I.1; I.2; I.3; I.6; II.5; II.6; III.1; III.3; III.5;
		Ngjyrat themelore të dritës	1	2.4.1; 2.4.5; 2.4.7	Matematikë	I.1; I.2; I.4; I.6; II.5; II.6; II.7; III.1; III.4; IV.1;
		Testi për vlerësim	1	2.4.3		
	Debat për testin	1	2.4.1; 2.4.3			
						III.1; III.4; IV.1
		Pasqyrat e rrafshëta.	1	2.4.1; 2.4.7	Matematikë	I.1; I.2; I.4; II.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;
		Thjerrat. Ushtrime numerike	1	2.4.1; 2.4.7	Matematikë	I.1; I.2; I.4; II.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;

## 10. Planet e orëve mësimore të periudhës III

PLANI I ORËS MËSIMORE 41			
<b>Fusha:</b> Shkenca natyrore	<b>Lënda:</b> Fizikë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> 6
<b>Koncepti:</b> II, III			
<b>Tema:</b> Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme			
<b>Njësia mësimore:</b> Elektriciteti veti e materies. Elektriciteti dhe ndërtimi i substancës			
<b>Fjalët kyçe:</b> qelibari, elektroni, elektriciteti, elektrizimi, lënda			
<b>RNK:</b> I.1; I.2; I.3; I.4; II.6; III.1; III.4; IV.1;			
<b>RNF:</b> II.3.1; III.4; IV.2; IV.16;			
<b>RNL:</b> 7.1;			
<b>Nxënësi:</b>			
1	Nga përvoja dhe shkollimi paraprak përshkruan dukurin e elektricitetit		
2	Përshkruan ndërtimin grimcor të substancës.		
<b>Kriteret e suksesit:</b>			
<b>Nxënësi:</b>			
1	Të kuptojë se elektriciteti është veti e materies, ndërsa procesi i krijimit quhet elektrizim		
2	Të kuptojë se kur dy e më shumë trupa elektrizohen mes tyre lind forca tërheqëse ose dëbuese		
3	Të dalloj natyrën e kësaj forcë prej të tjerave, për shembull gravitetit dhe elastike		
<b>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> libri, leckë të leshtë, ndonjë krehër ose tullumbace, skemën e modelit të atomit			
<b>Përdorimi i TIK-ut:</b> shihni në internet modelin e atomit			
<b>Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):</b> Kimia			
METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE			
Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit; Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstru eksperimentalisht elektrizimin e trupave. Fërko më leckë të leshtë krehrin ose tullumbacen dhe pastaj tërheq copa të vogla letre.</li> <li>• Në rast nevojë eksperimentin përsërite.</li> <li>• Përmes eksperimentit demonstru tërheqjen dhe refuzimin e trupave të elektrizuar (shih librin)</li> <li>• Me ndihmën e modelit të atomit sqaro dhe diskuto me nxënës ndërtimin e tij, ashtu që ata të kuptojnë se burimi i elektricitetit është ngarkesa elektrike e cila rrotullohet rreth bërthamës së atomit</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i nxënësve</b>			
Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Fletore pune.			
<b>Reflektimi për rrjedhën e orës</b>			

**PLANI I ORËS MËSIMORE 42****Fusha:** Shkenca natyrore**Lënda:** Fizikë**Shkalla:** 3**Klasa:** 6**Koncepti:** II, III**Tema:** Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme**Njësia mësimore:** Mënyrat e ngarkimit të trupave me elektricitet. Përçuesit dhe veçuesit.**Fjalët kyçe:** elektriciteti, ngarkimi, fërkimi, elektroskopi, përçuesit, veçuesit.**RNK:** I.1; I.2; I.3; I.4; II.6; III.1; III.4; IV.1;**RNF:** II.3.1; III.4; IV.2; IV.16;**RNL:** 7.2; 7.3;**Nxënësi:****1** Përshkruan dukurinë e ngarkimit të trupave me elektricitet.**2** Tregon shembuj të trupave përçues dhe veçues të elektricitetit.**Kriteret e suksesit:****Nxënësi:****1** Të kuptoj dhe të dalloj mënyrat e ngarkimit të trupave me elektricitet.**2** Të kuptoj dhe të dijë të punoj me elektroskop.**3** Të dalloj veçuesit nga përçuesit e elektricitetit.**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, leckë të leshtë, ndonjë krehër ose tullumbace.**Përdorimi i TIK-ut:** shihni në internet modelin e atomit**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Kimia.**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Demonstru eksperimentalisht mënyrat e elektrizimit të trupave (me fërkim dhe me induksion).
- Në rast nevojë eksperimentin përsërite.
- Shpjego parimin e punës së elektroskopit.
- Jep detyrë shtëpie që nxënësit të ndërtojnë elektroskopin.
- Shpjego se janë dy grupe trupash: njëra prej tyre e përçon elektricitetin ndërsa tjera jo. Grupi i parë quhen përçues, ndërsa i dyti veçues.
- Bashkërisht me nxënës, sillni ndonjë shembull të përçuesve dhe të veçuesve.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 43****Fusha:** Shkenca natyrore**Lënda:** Fizikë**Shkalla:** 3**Klasa:** 6**Koncepti:** II, III**Tema:** Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme**Njësia mësimore:** Rryma elektrike. Burimet dhe shpenzuesit e rrymës elektrike.**Fjalët kyçe:** elektronet e lira, lëvizja e elektroneve, rryma, burimet e rrymës, shpenzuesit.**RNK:** I.1; I.2; I.6; II.6; III.2; III.3; III.4; IV.6;**RNF:** II.3.1; III.1; III.4; III.9; IV.5; IV.7;**RNL:** 7.4; 7.5;**Nxënësi:**

1 Përshkruan qarkun elektrik si sistem fizik

2 Përshkruan burimet dhe shpenzuesit që i njeh

**Kriteret e suksesit:****Nxënësi:**

1 Të kuptoj se kur lidhet qarku elektrik atëherë arsyeja pse llamba elektrike ndriçon është lëvizja e orientuar e elektroneve

2 Të kuptoj se arsyeja e lëvizjes së orientuar të elektroneve është diferenca në numrin e elektroneve në mes të dy trupave (burimi i rrymës).

3 Të kuptoj dhe dalloj burimet prej shpenzuesve.

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:****Përdorimi i TIK-ut:****Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Kimia**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Rikujton qarkun elektrik si sistem fizik
- Le të ri demonstrojnë nxënësit punë e qarkut elektrik
- Tërheq vëmendjen në burim (bateri), përcjellës (tel) dhe llambë elektrike (shpenzues)
- Me ndihmën tuaj le të kuptojnë nxënësit se në bateri ekzistojnë dy shufra me numër jo të njëjtë të elektroneve. Njëra e shënjuar me + e tjetra me -. Kjo me minus ka tepriçë elektronesh ndërsa ajo me + mungesë. Për mes telit ndodhë lëvizja e orientuar e elektroneve prej shufrës me – kah ajo me +.
- Rikujto disa shpenzues të rrymës elektrike (llamba, reshjoja, frigoriferi, hekuri, etj..)

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 44****Fusha:** Shkenca natyrore**Lënda:** Fizikë**Shkalla:** 3**Klasa:** 6**Koncepti:** II, III**Tema:** Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme**Njësia mësimore:** Qarku elektrik.**Fjalët kyçe:** elektronet e lira, lëvizja e elektroneve, rryma, burimet e rrymës, shpenzuesit.**RNK:** I.1; I.2; I.6; II.6; III.2; III.3; III.4; IV.6;**RNF:** II.3.1; III.1; III.4; III.9; IV.5; IV.7;**RNL:** 7.6;**Nxënësi:**

1 Përshkruan qarkun elektrik si sistem fizik

2 Përshkruan mënyrën e lidhjes së burimeve dhe shpenzuesve në qarkun elektrik.

**Kriteret e suksesit:****Nxënësi:**

1 Të kuptoj dhe t'i njih elementet e qarkut elektrik.

2 Të dijë të lidh elementet (burimet dhe shpenzuesit) e qarkut elektrik

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, dy bateri, dy llamba, telin.**Përdorimi i TIK-ut:****Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Kimia**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Rikujton qarkun elektrik.
- Bashkërisht me nxënës ndërton qarkun elektrik me një bateri dhe një llambë.
- Pastaj me dy bateri dhe një llambë po ashtu ndërtojeni qarkun elektrik.
- Nxënësit le të marrin dy llamba dhe dy bateria dhe ta ndërtojnë qarkun elektrik, ndërsa ju vetëm ju ndihmoni në rast nevojë.
- Nxënësit duhet të kuptojnë rëndësinë dhe kujdesin që duhet të kenë kur të lidhin me shumë se një burim të rrymës elektrike (kujdesi duhet të jetë në polet e baterisë).
- Ta kuptojnë nxënësit arsyen se pse ndonjëherë përdoret më shumë se një bateri në qarkun elektrik.
- Shpjegoni se sipas nevojës mund të lidhen më shumë se dy bateri. Jepini shembuj praktik.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 45****Fusha:** Shkenca natyrore**Lënda:** Fizikë**Shkalla:** 3**Klasa:** 6**Koncepti:** II, III**Tema:** Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme**Njësia mësimore:** Veprimet e rrymës elektrike**Fjalët kyçe:** veprimi i rrymës, magnetik, optikë, mekanikë, termikë, botën e gjallë**RNK:** II.1; I.3; I.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1; IV.3;**RNF:** II.3.1; III.4; III.9; Iv.4; IV.5; IV.10; IV.16;**RNL:** 7.7;**Nxënësi:**

1 Përshekruan pajisjet të cilat punojnë me rrymë elektrike

2 Përshekruan arsyet pse i përdorim këto pajisje

**Kriteret e suksesit:****Nxënësi:**

1 Të kuptoj se me ndihmën e rrymës elektrike në kryejmë shumë punë dhe aktivitete

2 Të kuptoj dhe dalloj se punët që i kryejmë janë rezultat i veprimeve: termike, kimike, optike, mekanike dhe në botën e gjallë

3 Të edukohet se duhet të jetë i kujdesshëm gjatë punës me rrymë elektrike, sepse ajo ka edhe veprimin në botën e gjallë

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:****Përdorimi i TIK-ut:****Çështjet e ndërlydhura (korrelacioni):** Kimia, Biologjia**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);

Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

- Në bashkëbisedim me nxënësi numëroni disa nga pajisjet të cilat punojnë me ndihmën e rrymës elektrike
- Diskutoni se përse përdoren ato pajisje (për ngrohje, mbushje të baterisë, për ndriçim, për të kryer punë si për shembull thithje pluhuri, bluarje të kafes, etj.).
- Pastaj sqaroni se cili veprim i rrymës elektrike ndodhë te pajisjet e caktuara (termik ose i nxehtësisë, kimik, optik dhe mekanik)
- Kushtoni kujdes të veçantë veprimit në botën e gjallë të rrymës elektrike

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.**Reflektimi për rrjedhën e orës**



<b>PLANI I ORËS MËSIMORE 46</b>			
<b>Fusha:</b> Shkenca natyrore	<b>Lënda:</b> Fizikë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> 6
<b>Koncepti:</b> II, III			
<b>Tema:</b> Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme			
<b>Njësia mësimore:</b> Magnetet e përhershëm dhe të rrymës elektrike.			
<b>Fjalët kyçe:</b> magnetet, rryma elektrike, fusha magnetike.			
<b>RNK:</b> I.1; I.2; I.3; II.5; II.6; III.1; III.3; IV.1;			
<b>RNF:</b> II.3.1; III.2; III.3; III.9; IV.1; IV.5; IV.16;			
<b>RNL:</b> 7.8;			
<b>Nxënësi:</b>			
1 Përshkruan magnetet dhe vetit e tyre			
2 Përshkruan disa pajisje ose vegla ku gjejnë aplikime magnetet			
<b>Kriteret e suksesit:</b>			
<b>Nxënësi:</b>			
1 Të kuptoj se magnetizimi është veti e materies. Origjina është në ndërtimin grimcor të substancës ( atomi)			
2 Të kuptoj se magnetet janë trupa fizik të cilët për kohë të gjatë ruajnë vetit magnetike			
3 Të dijë dhe dalloj se magnetin ka dy anë të kundërta, të cilat quhen pole N dhe S			
4 Të kuptoj pse rreth përçuesit me rrymë zhvendoset treguesi i busullës			
5 Pse kur rryma ndalet nuk zhvendoset treguesi i busullës			
<b>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> libri, busulla, ndonjë magnet i përhershëm			
<b>Përdorimi i TIK-ut:</b>			
<b>Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):</b> Gjeografia, Kimia			
<b>METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE</b>			
Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve); Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren; Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasi nxënësit të evokojnë diturin e tyre për magnetet, demonstro eksperimentalisht tërheqjen dhe refuzimin mes magnetëve të përhershëm (modelet shkollore).</li> <li>• Le ti kushtohet vëmendje se kjo veti e këtyre magnetëve është e përhershme.</li> <li>• Sqaro se çfarë ndodhë nëse duam ti ndajmë magnetet.</li> <li>• Demonstro vendosjen e busullës afër telit të qarkut elektrik (nxënësit e njohin qarkun).</li> <li>• Bashkë me nxënës sqaroni se a pse nuk po zhvendoset treguesi i busullës kur nga qarku i rrymës elektrike hiqet burimi i saj.</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i nxënësve</b>			
Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Fletore pune.			
<b>Reflektimi për rrjedhën e orës</b>			

**PLANI I ORËS MËSIMORE 47**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** II, III

**Tema:** Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme

**Njësia mësimore:** Toka magnet i përhershëm. Magnetet e rrymës elektrike.

**Fjalët kyçe:** magneti, Toka, busulla, rryma elektrike,

**RNK:** I.1; I.2; I.3; II.5; II.6; III.1; III.3; IV.1;

**RNF:** II.3.1; III.2; III.3; III.9; IV.1; IV.5; IV.16;

**RNL:** 7.8;

**Nxënësi:**

1 Përshkruan përdorimin e busullës.

2 Përshkruan elektromagnetin.

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj fushën magnetike të Tokës.

2 Të dijë të aplikoj busullën.

3 Të kuptoj lidhjen ndërmjet rrymës elektrike dhe fushës magnetike.

4 Të dijë të ndërtoj elektromagnetin.

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, busulla, bateria, një gozhdë dhe teli metalikë.

**Përdorimi i TIK-ut:**

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Gjeografia, Kimia

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);  
Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

- Bashkërisht me nxënës përshkruani busullën dhe përdorimin e saj.
- Shpjegoni fushën magnetike të Tokës.
- Përshkruani orientimin në bazë të fushës magnetike të tokës.
- Ndërtoni elektromagnetin.
- Le të shohin nxënësit se si për rastin kur elektromagneti është i lidhur për baterie, ai tërheq trupa metalikë, ndërsa kur është i shkyçur nuk tërheq.
- Tregoni ndonjë shembull të aplikimit të elektromagnetit.
- Inkurajojini nxënësit të ndërtojnë elektromagnetin dhe të shohin praktikisht lidhjen e rrymës elektrike me fushën magnetike.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 48**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** II, III

**Tema:** Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme

**Njësia mësimore:** Ndikimi i magneve në trupa e tjerë

**Fjalët kyçe:** metale, hekuri, tërheq, feromagnetikë.

**RNK:** I.2; I.4; II.5; II.6; II.7; III.1; III.2; III.4; IV.1;

**RNF:** II.3.1; III.4; III.9; IV.1; IV.4; IV.5; IV.16;

**RNL:**7.9;

**Nxënësi:**

1 Përshkruan trupat që tërheq magneti

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj vetin tërheqëse të magnetit

2 Të kuptoj dhe dalloj se cilët trupa i tërheq magneti

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, magneti, disa trupa fizik në gjendje të ngurtë

**Përdorimi i TIK-ut:**

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Kimia

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);

Diskutimi dhe të nxënët në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Mësimdhënie përmes vërtetimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

- Demonstru eksperimentalisht bashkëveprimin e një magneti të përhershëm me disa trupa fizik të përzgjedhur.
- Bashkërisht më nxënës vendos në tabelë trupat të cilet i tërheq magneti dhe ata të cilët nuk i tërheq

I tërheq	Nuk i tërheq
Armaturën e çelikut	Letrën
...	.....

- Diskutoni tabelën

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 49**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** IV

**Tema:** Përhapja drejtvizore e dritës

**Njësia mësimore:** Drita dhe burimet e saj.

**Fjalët kyçe:** drita, burimet, tejdukshme, jo të tejdukshme, reflektuese

**RNK:** I.1; I.2; I.4; I.6; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;

**RNF:** II.3.1; III.1; III.4; III.6; III.9; IV.2; IV.4; IV.8; IV.16;

**RNL:**8.1;

**Nxënësi:**

1 Të përshkruaj burimet e dritës.

2 Të përshkruaj se çka ndodhë kur drita bie në një sipërfaqe.

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të njehë dhe të dalloj burimet natyrore nga ato artificiale të dritës.

2 Të kuptoj se çka ndodhë kur drita bie në një sipërfaqe të trupit.

3 Të dalloj sipërfaqet e tejdukshme, jo të tejdukshme dhe reflektuese.

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** librat, ndonjë burim i dritës

**Përdorimi i TIK-ut:** të hulumtoj në internet zënien e Diellit dhe Hënës

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Astronomia, Gjeografia, Matematika

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

- Në bashkëbisedim me nxënësit shpjegoni burimet e dritës.
- Dalloni burimet natyrore nga ato artificiale.
- Shpjegoni mekanizmin e të pamurit të trupave në natyrë.
- Shpjegoni se çka ndodhë kur drita bie në sipërfaqe të trupave.
- Dalloni trupat e tejdukshëm, jo të tejdukshëm dhe sipërfaqet reflektuese.
- Bashkërisht me nxënës sillni shembuj të trupave të tejdukshëm, jo të tejdukshëm dhe sipërfaqeve reflektuese.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi. Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 50**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** IV

**Tema:** Përhapja drejtvizore e dritës

**Njësia mësimore:** Përhapja drejtvizore e dritës. Hija dhe gjysmëhija. Zënia e Diellit dhe Hënës

**Fjalët kyçe:** drejtvizore, drita, hija, gjysmëhija, zënia e Diellit dhe Hënës

**RNK:** I.1; I.2; I.4; I.6; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;

**RNF:** II.3.1; III.1; III.4; III.6; III.9; IV.2; IV.4; IV.8; IV.16;

**RNL:**8.2;

**Nxënësi:**

1 Të përshkruaj dukuri të përhapjes drejtvizore të dritës

2 Të përshkruaj hijen dhe eventualisht gjysmë hijen

3 Të tregoj se çfarë din për dukurin e zënies së Diellit dhe Hënës

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj përhapjen drejtvizore të dritës

2 Të di të sqaroj formimin e hijes dhe gjysmë hijes duke u bazuar në përhapjen drejtvizore të dritës

3 Të dijë të sqaroj dhe dalloj zënien se Diellit dhe Hënës, po ashtu duke u bazuar përhapjen drejtvizore të dritës

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** librat, burim drite, karton letre me një vrimë

**Përdorimi i TIK-ut:** të hulumtoj në internet zënien e Diellit dhe Hënës

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Astronomia, Gjeografia, Matematika

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);  
Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Mundësisht në një dhomë të errët lësh burimin e dritës të bie nëpër hapje të kartonin. Pyet nxënësit se çfarë po vërejnë.

- Nëse keni mundësi atëherë me dy ose tre kartonë (shih fletoren e punë, detyra 8.9.) vërteto përhapjen drejtvizore të dritës.

- Sqaro formimin e hijes dhe gjysmë hijes.

- Rikujto dhe trajto zënien e Diellit dhe Hënës (pikënisje sistemi diellor). Nëse ka mundësi këtë dukuri hulumtoni bashkë me nxënës në internet ( ose ata vet le ta hulumtojnë në shtëpi).

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 51**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** IV

**Tema:** Përhapja drejtvizore e dritës

**Njësia mësimore:** Reflektimi dhe thyerja e dritës.

**Fjalët kyçe:** indeksi i thyerjes, reflektimi, thyerja

**RNK:** I.1; I.3; I.4; II.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1

**RNF:** II.3.1; III.3; III.9; IV.2; IV.5; IV.8;

**RNL:**8.3;

**Nxënësi:**

1 Të përshkruaj dukurin e reflektimit të dritës nga pasqyrat

2 Të përshkruaj si duken trupat fizikë në dy mjedise të ndryshme (p.sh. luga në gotën e ujit)

3 Të përshkruaj arsyen pse trupat fizikë në dy mjedise të ndryshme në sipërfaqen ndarëse duken si të thyera

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj indeksin e thyerjes si numër i cili shpreh marrëdhënien e dy shpejtësive në mjedise të ndryshme optike, vakum dhe mjedis tjetër

2 Të kuptoj se kur drita bie në sipërfaqe të materialit jo të tejdukshëm ajo mund të reflektohet

3 Të kuptoj se kur drita bie në sipërfaqe ndarëse të dy mjediseve të ndryshme transparente ajo ndryshon drejtimin e përhapjes- thyhet

4 Të kuptoj dhe dalloj ligjin e reflektimit dhe të thyerjes

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** librat, ndonjë pasqyre, gotë me ujë.

**Përdorimi i TIK-ut:**

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):**Matematika (Gjeometria)

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Shpjego se shpejtësia e përhapjes së dritës është më e madhja në vakum
- Trego se numri i cili fitohet duke pjesëtuar shpejtësinë e dritës në vakum ndaj asaj në mjedisin tjetër është më i madh se 1 dhe paraqet indeksin e thyerjes.
- Trego se çfarë ndodhë nëse në pasqyre bie drita. Diskuto me nxënës.
- Demonstro thyerjen e dritës përmes gotës me ujë në të cilën vendos lapsin ose lugën.
- Sqaro se në mjedise tjera shpejtësia e përhapjes së dritës është më e vogël se në vakum

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 52**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** IV

**Tema:** Përhapja drejtvizore e dritës

**Njësia mësimore:** Pasqyrat e rrafshëta.

**Fjalët kyçe:** pasqyrat e rrafshëta, reflektimi, shpërhapja

**RNK:** I.1; I.2; I.4; II.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;

**RNF:** II.3.1; III.4; III.6; IV.2; IV,5; IV.10;

**RNL:** 8.4;

**Nxënësi:**

1 Të përshkruaj dukurin e reflektimit të pastër (pasqyrimin)- rasti kur sipërfaqja është e lëmuar dhe reflektuese

2 Të përshkruaj dukurin e reflektimit jo të mirë, pra kur nuk duket qartë shëmbëllimi reflektues.

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj dhe dalloj reflektimin prej shpërhapjes

2 Të kuptoj dhe të jetë në gjendje të aplikoj ekuacionin e pasqyrave të rrafshëta dhe të gjej shëmbëllimin.

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** librat, pasqyra, mjedis jo të mirë reflektues (kjo mund të ju jepet edhe si detyrë nxënësve; të përcjellin ndonjë rast kur lumi pranë shkollës ose lagjes kur turbullohet si duket shëmbëllimi, shih librin bazë)

**Përdorimi i TIK-ut:**

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):**Matematika (Gjeometria)

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Demonstru reflektimin te pasqyra e rrafshët. Nëse ju jepet mundësia demonstru edhe reflektimin nga një sipërfaqe shpërhapëse, p.sh. sipërfaqja e ujit të trazuar).
- Praktishtë vërteto se pozita dhe dimensionet e shëmbëllimit ndaj pasqyrës janë të njëjta me atë të objektit.
- Shëno ekuacionin e pasqyrës.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

**PLANI I ORËS MËSIMORE 53**

<b>Fusha:</b> Shkenca natyrore	<b>Lënda:</b> Fizikë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> 6
--------------------------------	----------------------	-------------------	-----------------

**Koncepti:** IV

**Tema:** Përhapja drejtvizore e dritës

**Njësia mësimore:** Thjerrat

**Fjalët kyçe:** pasqyrat e rrafshëta, reflektimi, shpërhapja

**RNK:** I.1; I.2; I.4; II.4; II.5; II.6; III.1; III.4; IV.1;

**RNF:** II.3.1; III.4; III.6; IV.2; IV,5; IV.10;

**RNL:** 8.5;

**Nxënësi:**

1 Të përshkruaj dukurin e thyerjes së dritës në mjedisi të tejdukshme (ujë, thjerra).

2 Të shpjegoj arsyen se pse në rast nevoje bartim syze?

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj s kur drita kalon në mjedise të tejdukshëm ajo thyhet.

2 T'i njoh dhe t'i dalloj thjerrat përmbledhëse dhe ato shpërndarëse.

3 T'i njoh rrezet karakteristike dhe të jenë në gjendje të gjejë shëmbëllimin te dy llojet e thjerrave.

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** librat, thjerra të ndryshme ( p.sh. syze)

**Përdorimi i TIK-ut:**

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):**Matematika (Gjeometria)

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;



- Demonstru se çka ndodhë kur rrezet e dritës bien në gotën me ujë.
- Shpjego edhe shembuj kur drita bie në qelq.
- Shpjegon konceptin e thyerjes.
- Trego se çka janë thjerrat.
- Shpjego se cilat janë llojet e thjerrave.
- Trego se cilat janë rrezet karakteristike të cilat na mundësojnë të gjejmë shëmbëllimin e objektit.
- Merr shembuj të ndryshëm dhe gjej pozitën dhe madhësinë e shkëmbimit.
- Merr shembullin e syzave dhe shpjegon arsyen e përdorimit të tyre.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**



**PLANI I ORËS MËSIMORE 54**

**Fusha:** Shkenca natyrore

**Lënda:** Fizikë

**Shkalla:** 3

**Klasa:** 6

**Koncepti:** IV

**Tema:** Përhapja drejtvizore e dritës

**Njësia mësimore:** Instrumentet e thjeshta optike.

**Fjalët kyçe:** instrumentet e thjeshta, fokusi, objekti, shëmbëllimi.

**RNK:** I.1; I.2; I.3; I.6; II.5; II.6; III.1; III.3; III.5;

**RNF:** II.3.1; III.4; III.6; IV.2; IV.5; IV.8; IV.10; IV.12;

**RNL:** 8.5;

**Nxënësi:**

1 Të tregoj arsyen e përdorimit të syzave dhe llupës, periskopit (nëse ka dëgjuar) dhe teleskopit

2 Të tregoj mënyrën se si shihen objektet e largëta ose ato të cilat nuk mundem direkt ti shohim

3 Të tregoj nëse të kenë dëgjuar për periskop dhe teleskop

**Kriteret e suksesit:**

**Nxënësi:**

1 Të kuptoj funksionimin e thjerrave. Cilat janë karakteristikat optike të tyre.

2 Të kuptoj llupën si instrument të thjeshtë optik (thjerrë).

3 Të kuptoj ndërtimin dhe funksionimin e periskopit dhe teleskopit

**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** librat, syza, llupë, teleskop,

**Përdorimi i TIK-ut:**

**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):**Matematika (Gjeometria)

**METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

- Më bashkëbisedim sqaro përdorimin e syzave dhe llupës. Le të kuptojnë nxënësit mënyrën e funksionimit të tyre

- Trego dhe mundësisht demonstro funksionimin e teleskopit dhe periskopit.

- Jep udhëzim se si ndërtohet periskopi. Detyrë shtëpie: nxënësit në grupe të ndërtojnë periskopin.

**Vlerësimi i nxënësve**

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Fletore pune.

**Reflektimi për rrjedhën e orës**

<b>PLANI I ORËS MËSIMORE 55</b>			
<b>Fusha:</b> Shkenca natyrore	<b>Lënda:</b> Fizikë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> 6
<b>Koncepti:</b> IV			
<b>Tema:</b> Përhapja drejtvizore e dritës			
<b>Njësia mësimore:</b> Ngjyrat themelore të dritës.			
<b>Fjalët kyçe:</b> Dielli, ngjyra e bardhë, prizmi, zërthimi i dritës, ylberi.			
<b>RNK:</b> I.1; I.2; I.4; I.6; II.5; II.6; II.7; III.1; III.4; IV.1;			
<b>RNF:</b> II.3.1; III.3; III.4; III.9; IV.1; IV.2; IV.5; IV.16;			
<b>RNL:</b> 8.6;			
<b>Nxënësi:</b>			
1 Përshkruan paraqitjen dhe formën e ylberit.			
2 Tregojnë nëse kanë dëgjuar për mundësin e formimit artificial të ylberit			
<b>Kriteret e suksesit:</b>			
<b>Nxënësi:</b>			
1 Të kuptoj se drita e diellit është shumë ngjyrëshe dhe ajo mund të zërthehet.			
2 Të kuptoj arsyen e zërthimit të dritës së diellit kur kalon nëpër prizëm.			
3 Të kuptoj se ngjyrat e dritës së diellit kur kalon nëpër prizëm janë po ato që i ka edhe ylberi.			
4 Të dijë të prodhoj ylberin edhe kur nuk bie shi			
<b>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</b> librat, prizmi i qelqit, ena me ujë, pasqyre			
<b>Përdorimi i TIK-ut:</b>			
<b>Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):</b> Matematika (Gjeometria)			
<b>METODAT DHE RRJEDHA E ORËS MËSIMORE</b>			
Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit; Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstru se çfarë ndodhë nëse drita e diellit bie nëpër prizëm, ose nëpër gotën e xhamit me ujë.</li> <li>• Le të kuptojnë nxënësit se ngjyrat e dritës së diellit janë të njëjta me atë të ylberit.</li> <li>• Në bashkëbisedim sqaron se ylberi paraqitet si rezultat i kalimit të rrezeve të dritës nëpër pika të shiut.</li> <li>• Demonstru krijimin e ylberit ( shih librin bazë)</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i nxënësve</b>			
Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve, nëpërmjet pyetje dhe debatit; nëpërmjet nxjerrjes së përfundimeve nga demonstrimi . Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Fletore pune.			
<b>Reflektimi për rrjedhën e orës</b>			

## 11. Një model i testit vlerësues

Sipas shumë autorëve vetitë e një testi të mirë janë: objektiviteti, besueshmëria, vlefshmëria, përdorshmëria dhe standardet e vlerësimit. Këtu nuk do të ndalemi në shtjellim gjithëpërfshirës të këtyre vetive, por do të shënjojmë vetëm tri çështje shumë elementare që dalin nga to, e të cilat janë të rëndësishme themelore gjatë përpilimit të një testi: qartësia e testit, sinkronizimi i pyetjeve (kërkesave) të testit me kohën për zgjidhjen e tyre dhe struktura e testit sipas niveleve kognitive. Në të vërtetë, këto tri çështje janë aq themelore, sa nëse shkelen, atëherë lirisht mund të thuhet se testi është i dështuar qysh në fillim – qysh në përpilim të tij. Fatkeqësisht, nëpër shkollat tona shumë shpesh këto tri çështje shkelen, madje në mënyrë drastike.

**Qartësia e testit.** Pyetjet (kërkesat) e testit duhet të jenë të qarta, të plota dhe të mos lënë mundësi të interpretimit të dyfishtë. Nëse, gjatë testimit, nxënësit duhet t'i shtrojnë shumë pyetje mësimdhënësit për të kuptuar pyetjet (kërkesat) e testit, atëherë testi humbë shumë nga vlera e tij për shumë arsye.

**Sinkronizimi i pyetjeve (kërkesave) të testit me kohën për zgjidhjen e tyre.** Pyetjet (kërkesat) e testit duhet të jenë të zgjidhshme brenda kohës që kanë nxënësit në dispozicion. Nëse testi përmban shumë pyetje (kërkesa), zgjidhja e të cilave realisht nuk mund të arrihet brenda kohës që kanë nxënësit në dispozicion, ose arrihet, por kërkon angazhim maksimal deri në sekondën e fundit, atëherë kjo shkakton ngarkesë shumë të madhe të nxënësit dhe reflektohet në ulje të suksesit – madje deri në demoralizim të tyre. Mësimdhënësit kanë disa mundësi që të matin kohën që u nevojitet nxënësve për pyetje (kërkesa) të caktuara. Mundësia më e mirë është që këtë matje ta bëjnë gjatë ushtrimeve dhe debateve me nxënësit.

**Struktura e testit sipas niveleve kognitive.** Testi duhet të jetë i strukturuar në atë mënyrë që secili nxënës që ka ndjekur mësimet të mund të përballet me të. Kjo do të thotë se pyetjet (kërkesat) duhet të jenë të niveleve të ndryshme kognitive.

Në vazhdim, do të japim një model të përgjithshëm dhe një të veçantë të testit.

### Modeli i përgjithshëm i një testi me shkrim në fizikë.

Shkolla mesme e ulët ..... , Vendi ..... , më .....	
Test në Fizikë, klasa 6; Periudha .....	
1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dy pyetjet (kërkesat) e para mund të jenë të niveleve të ulëta kognitive (që nënkupton se për t'u përgjigjur në këto kërkesa mjafton mësimi në nivel informacioni dhe memorizimi i tyre).</li> </ul>
2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konkretisht, pyetjet (kërkesat) mund të jenë: detyra të thjeshta, që kërkojnë përdorim të formulave bazike; përshkrim i thjeshtë i ndonjë dukurie; riprodhimi i ndonjë ligji; numërim i vetive të ndonjë trupi, dukurie apo procesi; dhe të ngjashme.</li> <li>Qëllimi i këtyre dy pyetjeve (kërkesave) është që të gjithë nxënësit të jenë në gjendje të përballen me testin, pra edhe nxënësit, të cilët me mësimet që kanë marrë nuk shkojnë përtej mundësisë së riprodhimit të tyre.</li> </ul>
3	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dy pyetjet (kërkesat) në vazhdim mund të jenë të niveleve të mesme kognitive (që nënkupton se nga nxënësit kërkohet zbatim dhe ndërlidhje e njohurive të mësuara më parë për t'u përgjigjur në këto pyetje (kërkesa)).</li> </ul>
4	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konkretisht, pyetjet (kërkesat) mund të jenë: detyra që kërkojnë përdorim dhe kombinim të formulave për të ardhur deri te zgjidhja; krahasim të gjendjeve të veçanta me të përgjithshmet për të nxjerrë përfundim; zbatim të ligjeve në rrethana të veçanta; nxjerrje e përfundimeve nga ngjashmëritë dhe të veçantat e dukurive apo proceseve të ndryshme; formulim i problemeve të thjeshta me fjalë, për zgjidhjen e të cilave do të përdoret formula bazike; dhe të ngjashme.</li> <li>• Qëllimi i testit me këto pyetje (kërkesa) është që të krijohet mundësia për të dalluar nxënësit të cilët mund të zbatojnë në nivel të kënaqshëm mësimet që i kanë marrë, nga nxënësit që janë në gjendje vetëm të reprodukojnë mësimet që i kanë marrë.</li> </ul>
5	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetja (kërkesa) e fundit do të ishte e nivelit të lartë kognitiv (që nënkupton se nga nxënësit pritet analizë, inovacion, të menduar kritik).</li> <li>• Konkretisht, pyetjet (kërkesat) mund të jenë: detyra që kërkojnë analizë të gjendjes dhe kombinim të formulave dhe ligjeve për të ardhur deri te zgjidhja; nxjerrje analitike të madhësive të ndryshme, të cilat në libër janë dhënë në rrugë të shkurtë; krahasim të gjendjeve të veçanta me të përgjithshmet për të nxjerrë përfundim dhe paraqitja e tyre analitike; zbatim të ligjeve në rrethana të veçanta dhe paraqitja analitike e zbatimit; formulim i problemeve të ndërlikuara me fjalë, për zgjidhjen e të cilave do të përdoret formula dhe ligje të caktuara; dhe të ngjashme.</li> <li>• Qëllimi i testit me këtë pyetje (kërkesë) është krijimi i mundësisë që të dallohen nxënësit që janë në gjendje të bëjnë analiza, inovacione dhe të shfaqin mendim kritik.</li> </ul>

Një test i përpiluar duke u bazuar në modelin e përgjithshme të testit.

	<p><b>Shkolla e mesme e ulët..... , Vendi ..... , më .....</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Test në Fizikë, klasa 6; Periudha I</b></p>
1	Shëno njësit matëse për masën dhe vëllimin?
2	Përkufizo peshën, shëno formulën, dhe njësinë matëse të saj?
3	Nëse treguesi i shpejtësi matësit në makinë tregon shpejtësinë prej 72km/h, atëherë sa është shpejtësia e lëvizjes së makinës në njësinë m/s?
4	Një madhësi fizike e kanë matur dy grupe të ndryshme nxënësish. Në grupin e parë ishin 5 veta, ndërsa në atë të dytin 8 veta. Secili anëtar i grupi ka matë madhësinë veç e veç dhe kanë shënuar rezultatin matës. Në fund ata kanë gjetur vlerat mesatare të matjes. Çfarë mendoni, cili nga grupet e ka saktësinë e matjes më të madhe , dhe pse?
5	Nëse klasa e jonë është e gjatë 7.5m dhe e gjerë 6m, atëherë sa ari është sipërfaqja e saj?